

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

Resurset gjenetike të pemëve frutore

(Një pasuri e madhe kombëtare)

Vendi ynë aktualisht përbën një vatër me burime të pasura gjenetike të cilat duhet të njihen, të mbrohen, të grumbullohen, të studjohen dhe të shfrytëzohen në dobi të kërkimit shkencor dhe prodhimit për të krijuar varietete të reja më të mira, të afta për të shfrytëzuar në maksimum mjedisin, për të dhënë prodhime të larta e të përvitshme, me cilësi të kushtëzuar sipas drejtimit të shfrytëzimit.

Llojet e ndryshme të pemëve frutore dallohen ndërmjet tyre nga një seri veçorish biologjike e botanike, nga kërkesa të ndryshme eko-pedo-klimatike, nga manifestime të qëndrueshmërisë së ndryshme ndaj kufijve ekstrem të faktorëve të mësipërm apo patogjeneve të ndryshëm, veçori këto që kanë qëndruar edhe në bazë të shkallës së përhapjes së tyre në zona e rrethe të ndryshme të vendit.

Sot, shoqëria konstaton se ajo nuk mund të krijojë të ardhmen e saj, pa një botë të pasur resurcesh dhe e gjithë kjo si për arsye ekonomike dhe shoqërore, ashtu dhe mjedisore e kulturore. Periudha e tranzicionit që kaloi dhe kalon vendi ynë e thelloi akoma më shumë procesin e erozionit të resurseve të pemëve frutore e hardhisë pasi mungesa e ruajtjes në kushte të kontrolluara, mungesa e një legjislacioni për ruajtjen e këtij fondi si dhe mungesa e një mbështetjeje financiare të fermerit, po rrezikon çdo ditë këtë pasuri të madhe kombëtare.

Mbrojtja e germoplazmës është një problem aktual për të gjitha vendet dhe për të gjitha speciet bimore. Sot, kudo në botë po punohet për të ndaluar këtë “hemoragji bimore“ me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e varieteteve autoktone aq të domosdoshëm për çdo komb.

Vendi ynë për shkak të pozicionit gjeografik, diversitetit në përbërjen pedologjike, hidrologjike, relievit dhe faktorëve klimatik, karakterizohet nga një biodiversitet i konsiderueshëm. Pjesë e këtij biodiversiteti është edhe germoplazma e pemëve frutore. Eksplorimi i zonave tipike të kultivimit të pemëve frutore tregon, se ekziston një llojshmëri e pasur në pemët frutore, e trashëguar nga të parët tanë prej shekujsh, e shtuar dhe e pasuruar nëpërmjet përzgjedhjes së llojeve më të çmuar të vendit, apo të sjella nga vendet e tjera, me karakteristikat më të dëshiruara.

Resurset gjenetike të pemëve frutore janë pjesë e rëndësishme e biodiversitetit të ekosistemit tonë, që ka rrjedhur si rezultat i procesit të vazhdueshëm të rikombinimeve të geneve në shekuj, dekada, e vite, të shfrytëzuar nga gjenerata në gjeneratë duke përbërë kështu një pasuri mjaft të çmuar për njerëzimin.

Vendi ynë, ka tradita të lashta në kultivimin e pemëve frutore: një pjesë e madhe e llojeve të kumbullave, si kumbulla e Beut, kumbulla e sheqerit, kumbulla Vlonjate apo lloje të ndryshme qershie, si Belica e kuqe, Belica e zezë, Zhitom, Dollmas etj.,

Një pjesë e mirë e këtyre llojeve kanë arritur edhe në ditët tona. Ruajtja e tyre është domosdoshmëri me rëndësi kombëtare, për faktin se është e lidhur ngushtë me vlerat kulturore të një vendi. Ajo mbart, jo vetëm traditën dhe lashtësinë e kultivimit por, edhe veçantitë dhe karakteristikat që e dallojnë atë nga vendet e tjera.

Resurset gjenetike të pemëve frutore, rëndësia dhe ruajtja e tyre janë tema aktuale për qarqet kërkimore shkencore jo vetëm për vet vlerat që ato mbartin por edhe për faktin se diversiteti i jetës bimore në tokë po përballet me një problem serioz, siç është ai i erozionit gjenetik, fenomen të cilit nuk i ka shpëtuar as pentaria.

Ashtu si gjendja e germoplazmës në përgjithësi ashtu dhe ajo e pemëve frutore në veçanti në vendin tonë është tepër shqetësuese. Për shkak të disa faktorëve kjo pasuri gjenetike e rëndësishme dhe e pazëvendësueshme e përbashkët për njerëzimin dhe tepër e vlerësuar për mbijetesën e tij, po shkatërrohet me shpejtësi të pabesueshme.

Një pjesë e mirë e kësaj germoplazme me veçori të larta ndaj kushteve të mjedisit sidomos për qëndrueshmërinë ndaj thatësirës e të ftohtit, sëmundjeve e dëmtuesve si dhe në shumë raste përmbajtjes dhe cilësive organoleptike, tashmë nuk egziston. Germoplazma e pemëve frutore nën tryshinë e shumë faktorëve, vazhdimisht po pëson një tkurrje, vit pas viti po varfërohet nga genet përgjegjëse të prodhimit dhe cilësisë.

Shkaqet kryesore që kanë shkaktuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në këtë erozion gjenetik në pentari në mënyre direkte ose indirekte janë pa dyshim:

- Rritja e popullsisë;
- Aplikimi i politikës bujqësore “produktiviste” prej qeverisë së viteve të periudhës së monizmit;
- Shpyllëzimet pa kriter për krijimin e tokave të reja;
- Katastrofat natyrore, zjarret, thatësirat e gjata;
- Përhapja në masë e sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Mungesa e legjislacionit dhe politikave speciale në mbrojtje të këtyre ekosistemeve;
- Braktisja e fshatit në mënyrë masive, duke prishur në këtë mënyrë atë lidhje aq të ngushtë të njeriut me mjedisin dhe natyrën;
- Vlerësimi i germoplazmës së huaj dhe nënvlerësimi i popullatave dhe i kultivarëve të vendit;
- Mungesa e një programi për të shfrytëzuar në mënyrë racionale resurset gjenetike bimore.

Në këto kushte, pavarësisht nga niveli i ulët ekonomik, në të cilën ndodhet shoqëria jonë duhen gjetur rrugët për të penguar këtë erozion.

Resurset gjenetike janë pasuri kombëtare e krijuar prej brezash. Ndërhyrja duhet të jetë e menjëhershme me punë përzgjedhëse dhe përmirësuese, me krijimin e blloqeve “mëmë”, për sigurimin e materialit të certifikuar për shtim, me studime rajonizuese për shtrirjen e pentarisë dhe për ta vendosur këtë sektor prioritar të bujqësisë në zhvillimin me baza shkencore.

Ruajtja në fermë e resurseve gjenetike autoktone të kulturave drufrutore.

Vendi ynë, për pozitën gjeografike të vendosjes në pellgun e Mesdheut, ka një larmi të madhe kulturash bujqësore duke filluar nga ato një vjeçare e deri tek bimët drufrutore e ato pyjore.

Kushtet e përshtatshme klimtiko-tokësore, me klimë të butë subtropikale për pjesën jugperëndimore dhe klimë të freskët deri në kontinentale për zonën verilindore me reshje të vazhdueshme dhe të bollshme gjatë vitit, kanë lejuar që në vendin tonë të gjejmë kushte të përshtatshme për rritje dhe zhvillim një sasi e konsiderueshme bimësh bujqësore, duke filluar nga ato njëvjeçare, shumëvjeçare, kulturat drufrutore, pyjoret duke e cilësuar vendin tonë si një oaz në pellgun e mesdheut me florën dhe faunën shumë të pasur. Në qoftë se në rajonin e Mesdheut, mendohet të jenë rreth 9000 lloje të ndryshme të florës së egër dhe asaj të kultivuar, 30 % e tyre gjenden në vendin tonë.

Kjo dëshmon për një pasuri të madhe kombëtare në fushën e resurseve të germoplazmës botërore.

Origjina e këtyre bimëve, humbet në thellësinë e shekujve, ku një sasi e konsiderueshme e tyre e kanë prejardhjen nga trevat tona të banuara nga të parët tanë.

Kjo pasuri është ruajtur brez pas brezi duke u kujdesur që të mos dëmtohet e shtuar me bimë të reja që kishin vlera ekonomike si burim ushqimi.

Edhe në vitet më të vështira, bujku shqiptar ka pakësuar racionin e tij ushqyes dhe ka mbajtur farën që i është dashur për prodhim në vitet e ardhshëm.

Në qoftë se do të kthehemi në retrospektivë, historinë e zhvillimit, ruajtjes dhe përmirësimit të resurseve autoktone të bimëve bujqësore do ta ndanim në tre periudha.

1. Periudha parahistorike. Kjo periudhë i përket epokës së njeriut primitiv që ushqehet me frutat e bimësisë natyrale që i gjente në mënyrë spontane në pyll dhe në ambiente të tjera, në afërsi të vendeve ku jetonte, kjo periudhë vazhdoi deri në momentin kur ai u bë i vetëdijshëm se këto bimë shërbenin si burim ushqimi duke i transferuar pranë qendrës së banimit duke u shërbyer, ruajtur dhe kujdesur vazhdimisht.

Kjo periudhë ka zgjatur shumë, ku ruajtja e bimëve të quajtura bujqësore i është nënshtruar seleksionimit të vazhdueshëm natyral. Me kalimin e kohës, kur njeriu primitiv filloi të evoluojë, të kuptonte, të mendonte dhe të vepronte në dobi të vetes, fillon një etapë e re në drejtim të seleksionimit dhe ruajtjes së bimëve bujqësore.

Periudha e mëvonshme e qytetërimit Ilir u karakterizua nga një zhvillim i vrullshëm i bujqësisë dhe blegtorisë.

2. Periudha e dytë mund të konsiderohet ajo që zë vend ndërmjet zhvillimit Ilir dhe atij Bizantin.

Për këtë periudhë, kemi një zhvillim të vrullshëm të bujqësisë dhe blegtorisë, e cila evidentohet me tregtinë dhe shkëmbimet që bëheshin me fise të ndryshme të shteteve përreth pellgut të Mesdheut si: Greqia, Italia, Turqia, Egjypti etj., ku prodhimet bujqësore si: vaji i ullirit, vera, mishi, leshi etj., tregtoheshin dhe shkëmbeheshin me mallra të ndryshme të prodhimit artizanal. Kësaj periudhe i përket njohja e kultivarëve të rrushit të Shkodrës, Durrësit, Vlorës, Përmetit etj., vajit të ullirit të Himarës, Sarandës, Vlorës, Berarit etj., mjaltit të Çajupit, Korçës etj., mollëve dhe dardhëve të Korçës, Voskopojës, Ersekës etj., portokalleve, qitrove e limonave të zonës bregdetare.

Në këtë periudhë kemi shkëmbime të ndryshme tregtare dhe të marerialit bimor si: farëra e fidana të pemëve frutore të cilat revokojnë zhvillimin e bujqësisë, tregtisë dhe shkëmbimeve reciproke midis fiseve të shteteve përreth pellgut të Mesdheut. Nga lëvizjet e shumta tregtare të kësaj periudhe, mendohet se një pjesë e këtyre resurseve të jenë marrë nga këto zona. Prej shumë vitesh dhe shekujsh një pjesë e këtyre kultivarëve që i rezistuan kushteve të ambientit të ri u përshtatën duke krijuar vlera të reja, jo vetëm përsa i përket cilësive biologjike por dhe shijeve organoleptike, duke u shdërruar dhe marrë karakteristikat e kultivarit autokton.

Në këtë periudhë u zhvillua shumë vreshtaria, ullishtaria dhe kopshtaria e perimeve, këto zhvillime i gjejmë deri në kohën e Skënderbeut i cili vuri detyrime për mbjelljet e reja për çiftet që martoheshin.

Periudha pas vdekjes së Skënderbeut dhe pushtimit të vendit nga Turqia, njeh dy etapa diametralisht të kundërta përsa i përket ruajtjes dhe zhvillimit të bujqësisë:

- E para ka të bëjë me rrënimin e ekonomisë së vendit si rezultat i luftimeve të shumta e të zgjatura të cilat shkatërruan shumë zona të zhvilluara të ullishtarisë e vreshtarisë, nga djegiet, nga mosshërbimi prej izolimit të popullsisë, largimet për t'i shpëtuar uzupatorit etj.

- Etapa e dytë e rimëkëmbjes së ekonomisë, pas reformave të Tanzimatit që vazhdoi deri në momentin e shpalljes së pavarësisë dhe fillimit të luftës së parë dhe të dytë botërore. Në këtë periudhë kemi një zhvillim të shpejtë të bujqësisë për vetë natyrën e sistemit ekonomik të vendit si një vend feudoborgjez, që nuk doli nga korniza e feudalizmit të zhvillimit tipik bujqësor dhe një industrie artizanale pa teknologji të kohës.

Kësaj etape i përket edhe periudha e Mbretërisë së Zogut, i cili hodhi themelet e para të shtetit të ri demokratik. Me ligjet e dala nga shteti i asaj kohe u përcaktuan drejtimit e zhvillimit të bujqësisë duke i vënë theksin kadastrimit të tokës, inventarizimit të kulturave drufrutore, ngritjen e të parës fidanishte për prodhimin e fidanave frutor në Laprakë të Tiranës, sasisë e sipërfaqes së tokës që mbillej, numrin e bagëtive që mbarështroheshin si dhe masat që duheshin marrë për sëmundjet karantinore dhe atyre me pasoja për jetën e njerëzve etj.

Megjithëse nuk kemi një evidentim të saktë për këtë periudhë, mendohet se kulturat bujqësore në përgjithësi dhe ato autoktone në veçanti, u ruajtën, u shumëzuan dhe u kultivuan nën kujdesin e individit, në fermë pa një legjislacion apo metodikë të posaçme, por në sajë të eksperiencës së individit, zonës dhe trevave.

Kështu p.sh. pas të korrave, bujku në lëmë përpara se të linte sasinë për ushqim deri në të korrat e ardhshme mbante farën që do t'i nevojitej për mbjelljet e reja, për kulturën e misrit zgjidhte kallinj të mirë, si nga madhësia ashtu dhe nga kokrra i lidhte varg me njëri-tjetrin dhe i vendoste në vende të përshtatëshme, në katet e poshtme të shtëpisë, në ambiente të thata, të ajrosura, pa ndriçim diellor, pa lagështi të tepërt etj. Nga jeta kishin nxjerrë mësim dhe mësimet ishin kthyer eksperiencë në vite. Në kushte shtëpiake bujqit ruanin të gjitha prodhimet që do t'u shërbenin si zjarre gjatë vitit.

Në qypa balte të llakuar ruhej vaji i ullirit, vera, rakia, turshitë, ullinj të kripur etj., duke i tymosur dhe kripur ruhej mishi në formën e pastërmasë.

Shprehja “fshat e zanat, derë e tabjat”, bëri që në shumë krahina të vendit tonë të kishte eksperiencë të ndryshme për ruajtjen e prodhimeve bujqësore, padyshim përbën dhe ruajtjen e resurseve autoktonë në një farë mënyre. Ndryshe veprohej në zonat verilindore,

ndryshe veprime në zonat fushore dhe eksperiencat e tjera pasqyrohen në zonën jugore.

Kushtet e ndryshme atmosferike të vitit, kanë ndikuar dhe krijuar praktika të ndryshme për ruajtjen e prodhimeve dhe trashëgimisë gjenetike të resurseve. Kështu p.sh. në zonën e Korçës dhe të Dibrës, me dimër të ftohtë e të zgjatur me temperatura nën 0°C, patatet, mollët, lakrat etj., i ruajnë në transhe të mbuluara me dhe, duke krijuar një eksperiencë më vete ndryshe nga ata të zonës fushore që i ruajnë në qilarët e shtëpisë ose katet e poshtme të tyre, metoda këto që kanë filluar të zgjohen dhe zbatohen edhe sot, edhe pse kushtet e tanishme flasin për një modernizim të ambjentëve të kontrollueshme, të parametrave si: temperatura, lagështia, ajri etj.

3. Periudha e tretë i përket kohës së socializmit.

Kësaj periudhe i takon koha nga momenti i reformës agrare deri në vitet 1990.

Kjo periudhë prej afërsisht 50 vjetësh njohu ndryshime të shumta, ndryshime në pakësimin sasior të resurseve autoktone jo vetëm të sasisë numerike por dhe të pakësimin të kultivarëve si dhe të shtimit të sipërfaqeve të mbjella me kultivarë të introduktuar dhe më pak me resurse autoktone.

Gjatë kësaj kohe u ngritën institucionet e para shkencore, Universiteti Bujqësor në Tiranë, ndërmarrjet e prodhimit të farave dhe fidanave, Inspektoriati i Mbrojtjes së Bimëve dhe shumë hallka të tjera që varen nga MB-së për një trajtim shkencor të mbjelljeve dhe ruajtjes së germoplazmës së vendit.

U krijuan Stacione Qendrore Shkencore të frutikulturës, perim-patates, misër-orizit, duhanit, tokave, mbrojtjes së bimëve, bimëve të arave dhe atyre foragjere etj., më vonë deri në fund të vitit 2006 u shdërruan në institute kërkim-shkencore dhe pas reformës në fushën e shkencës u transformuan në Qendra të Transferimit të Teknologjive Bujqësore.

Këto institute punuan në bazë të një programi afat-mesëm dhe afat-gjatë në fushën e identifikimit, grumbullimit, koleksionimit dhe studimit të resurseve autoktone.

Në bazën eksperimentale të Shamogjinit u ngrit koleksioni i ruajtjes dhe studimit të germoplazmës së hardhisë me 400 kultivarë nga të cilët 70 të vendit, koleksioni i ullirit me 18 kultivarë nga të cilët 10 të vendit, koleksioni i agrumeve me 48 kultivarë nga të cilët 8 të vendit dhe koleksioni i pemëve frutore me 80 kultivarë nga të cilët 29 të vendit.

U krijuan parcelat demonstrative me ullinj, pemë, agrume dhe vreshta ku nëpërmjet metodikave të posaçme u zbatuan teknika dhe teknologji të reja për mbarështrimin e pemëtoreve.

Kjo periudhë u karakterizua nga mbjellje masive në bazë të politikave të monizmit duke ndërhyrë në ekosistemin, duke prekur pyjet në kurriz të shtimit të sipërfaqeve të reja të tokës.

Kjo ndërhyrje në ekosistem, prish ekuilibrat biologjik të vendosur në kohë dhe hapsirë; për shumë zona solli dëme të pallogaritshme duke nxitur erozionin, gërryerjen e tokës dhe sipërfaqes më produktive, për krijimin e së cilës janë dashur mijra vjet, e bashkë me të u shkatërrua dhe një pjesë e konsiderueshme e resurseve autoktone në bimët pyjore, shkurret, bimët medicinale dhe pemët frutore etj..

Dëmin më të madh e pësoi natyra, flora dhe fauna e këtyre zonave.

Me kolektivizimin e bujqësisë një pjesë e resurseve autoktone të pemëtarisë u dëmtuan nga sistemimi dhe parcelizimi i sipërfaqes së tokës, nga drejtimi dhe planifikimi i centralizuar që morën ekonomitë bujqësore.

Nga ky organizim shpëtuan ato pak resurse që u gjendën përreth oborrit të familjes fshatare, duke u zbehur gjithmonë e më shumë kujdesi për to, me futjen e kultivarëve të rinj që erdhën nga importi pa u thelluar në vlerat e tyre, në jetëgjatësinë e përshtatjen me kushtet e ambientit etj.,

Pas viteve 90 fillon periudha e re, ajo e kalimit nga ekonomia e centralizuar në atë të tregut të lirë, kjo periudhë u karakterizua nga rregulla dhe ligje të reja për t'ju përshtatur më mirë lirisë së individit.

Institucionet shkencore u ruajtën por j'u dha drejtim i ri pune në funksion të mbështetjes dhe realizimit të objektivave politikbërëse të kohës, të cilat hidhnin dritë mbi rrugë të reja të zhvillimit të kapitalizmit në përgjithësi dhe të bujqësisë në veçanti.

IP Vlorë (sot QTTB Vlorë), e mbështeti punën e tij në bazë të programeve dhe projekteve të zhvillimit me detyrë parësore prodhimin e materialit bimor të çertifikuar, grumbullimin, ruajtjen, koleksionimin dhe karakterizimin e germoplazmës së vendit dhe atë të ardhur vite më parë që i ishte përshtatur mirë kushteve të vendit tonë.

Këto programe dhe projekte u mbështetën dhe financuan nga MBUMK, MASH, institucione e organizma të tjera që veprojnë në trajtën e OJF, Mada, FAO; projekte me të huajt në kuadër të bashkëpunimit, etj.

Në këtë kuadër nga ish IP Vlorë dhe më pas nga QTTB-ja, u organizua puna për njohjen, grumbullimin dhe ruajtjen e resurseve autoktone dhe atyre të introduktuara për kulturat drufrutore.

Si rezultat i një pune disa vjeçare u realizuan disa projekte me financime të mësipërme për krijimin e bankës gjenetike.

Në këtë punë u shfrytëzuan njohuri që ekzistonin nga specialistët e vjetër të këtij institucioni që ishin në marrëdhënie pune dhe u aktivizuan dhe specialistë të tjerë të jashtëm, agronom të vjetër, fermerë të apasionuar, specialistë të shërbimit këshillimor të DB-së, të prefekturave etj.

Ekspeditat e ngritura dhe grupet e punës eksploruan, evidentuan, grumbulluan, shtuan dhe vendosën për ruajtje në fushat e koleksionit materialin bimor të prodhuar në bazën eksperimentale divulgative të Shamogjinit.

Nga puna kërkimore-studimore e kryer nga specialistët e Institutit të Pemëtarisë janë arritur të eksplorojnë, evidentohen dhe ruhen me qindra aksesione të pemëve frutore, hardhisë, ullirit e agrumeve.

Specia e mollës me 39 aksesione të zbuluara *in situ*, në komunat e Peshkopisë, Matit, Tiranës, Elbasanit, Librazhdit, Pogradecit, Korçës, Bilishtit, Ersekës, Vlorës etj.,. Këto aksesione kanë emërtimin përkatës sipas vendndodhjes dhe fermerëve që i kanë në pronësi.

Vlera e germoplazmës autoktone

Germoplazma autoktone paraqet vlera të larta të cilat duhen shfrytëzuar në përmirësimin e strukturës varietore dhe si material bazë për përmirësim gjenetik. Frutat e germoplazmës autoktone kanë shije të mirë organoleptike, ato paraqesin qëndrueshmëri dhe stabilitet të përvitshëm të prodhimit.

U janë përshtatur mirë kushteve të mjedisit dhe kanë qëndrueshmëri ndaj faktorëve stresant biotik dhe abiotik.

Kanë hershmëri në pjekje dhe vargëzim të prodhimit dhe të konsumit.

Për këto dhe të tjera cilësi resurset autoktone duhet të ruhen, të studjohen dhe për ato që manifestojnë vlerat e mësipërme të rekomandohen për t'u përhapur në mbjelljet e reja duke u kataloguar në strukturën varietore të mbjelljeve.

- Specia e mollës (*malus sp*) me 39 aksesione të eksploruar nga ekspeditat në shumë fshatra dhe fermerë të vendit përbën një fond të mirë për t'u patur në konsiderat.

Është analiza e elektroforezës ajo që do të përcaktojë përfundimisht nëse janë kultivarë vendi apo të ardhur kohë më parë në rajonet përreth për një pjesë të tyre. Gjithsesi brenda tyre ka kultivarë autoktonë si molla e Zhejit, molla Gjeçe, molla Verige, molla Verore në Korçë, molla Verore në Golem, molla e Verdhë në Kuç të Vlorës etj., që njihen dhe kanë vlera të admirueshme për cilësitë e frutit, shijen organoleptike, hershmërinë në pjekje, kohën e zgjatur të konsumit deri vonë në dimër, qëndrueshmërinë ndaj faktorëve stresant etj., prandaj duhet të merren në konsideratë dhe të ruhen nga erozioni gjenetik. Të gjitha këto aksesione gjenden të ruajtura në fermat (kopshtet pranë shtëpive të banimit), në gjendje të kultivueshme (foto molle).

-Specia e dardhës (*pirus sp*) me 74 aksesione.

Resurset e dardhës me 74 aksesione të eksploruara në të gjitha zonat klimatike të vendit duke filluar nga ato me klimë të ftohtë e deri në ultësirat jug-perëndimore.

Në larminë e germoplazmës së dardhës ka forma dhe kultivarë të cilët manifestojnë cilësi të dëshiruara të prodhimit të lartë e të stabilizuar, me vlera të larta agrobiologjike, me madhësi të ndryshme të frutit, me një periudhë të gjatë konsumi pothuajse gjatë gjithë vitit dhe përshtatje ndaj kushteve klimatiko-tokësore.

Në fondin e madh të germoplazmës të kultivarëve të dardhës mund të përmendim disa prej tyre që janë nga më të pëlqyeshmit dhe prodhuesit:

1. Dardha Bardhje kultivar me prejardhje vendi me përhapje të gjerë në Tiranë, Elbasan, Librazhd, Shkodër dhe Lezhë.

2. Dardha Bishtje kultivar i përhapur gjerësisht në jug të vendit por, gjendet dhe në Shqipërinë e mesme si në Elbasan, Berat, Tiranë etj., mjaft prodhues me shije dhe aromë të këndshme.

3. Dardha Bukje e eksploruar në fshatin Gur-Bardhë-Linas Tiranë.

4. Dardha Dimërore është një popullatë e pasur ku përfshihen shumë forma të ndryshme.

5. Dardha dimërore e Librazhdit, Xibrit.

6. Dardha Elbore është e përhapur gjerësisht në Shqipërinë e jugut dhe të mesme, piqet në muajin Qershor në kohën e korrjes së elbit ndaj ka marrë dhe këtë emër; fruti në pjekje ka konsistencë mielllore me formë të bukur dhe tepër aromatik, pak rezistent pas periudhës së pjekjes, nuk duron ruajtje në mjedise të zakonshme.

7. Dardha Kuqe me shumë sinonime e përhapur në mjaft treva të vendit në formën e popullatave të ndryshme nga Shkodra, Tirana, Elbasani, Berati, Mallakastra, Vlora, Saranda, Gjirokastra, Përmet etj. Shumë prodhuese me lëng dhe kohë zgjatje konsumi, pas vjeljes ruhet në kushte të shtëpisë.

8. Dardha Gushtje e Tiranës.

9. Dardha e Karkanjazit gjendet në fshatin me të njëjtin emër në Berat.

10. Dardha Lënge, Mjellçe, Stambollie e Librazhdit, Sherbetlie etj.

Të gjithë këta kultivarë, forma dhe popullata ndodhen në ruajtje *on farm* nga pronarët.

Është e nevojshme që pranë koleksioneve të institucioneve shkencore të tërhiqen një pjesë e atyre që manifestojnë vlera të larta për një ruajtje më të garantuar.

- Specia e kumbullës (Prunus sp).

Në specien e kumbullës për zonat e marra në studim nga ekspeditat janë evidentuar 35 aksesione të ndryshëm.

Ato janë të emërtuara sipas vendeve, ngjyrës së frutit dhe tultit. Në larminë e madhe të kultivarëve të kumbullës janë eksploruar dhe ato të egra që shërbejnë për prodhimin e farës për shtim.

Ndër kultivarët më të përhapur në vendin tonë mund të përmendim:

1. Vadrare e verdhë e hershme është e përhapur në të gjithë vendin sidomos në kopshtet e qyteteve dhe të fshatrave, ka arritur të mbijetojë në saëj të qëndrueshmërisë, prodhimit të përvitshëm i cili përdoret për konsum të freskët dhe më shumë për përpunim për prodhim rakie.
2. Vardare e kuqe e vendit, edhe ky kultivar gjendet në të njëjtat mënyra si Vardaria e verdhë.
3. Bardalike e përhapur më shumë në Shkodër e deri në Tiranë. Pemë me rritje të fuqishme dhe mjaft prodhuese.
4. Tropojane, Kumbulla e Zezë e Ballkanit. Ky kultivar ka shekuj që ka zënë vend në Tropojë dhe nga studimet e ndryshme të kryera në vend rezulton të jetë kumbulla më e mirë për tharje.
5. Kumbulla Shëngjinase, Vlonjate, Xhanarike e Melanie e Nepravishtës etj.